



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi: GJEOGRAFI

TITULLI I LËNDËS

GJEOGRAFIA POLITIKE E SHQIPËRISË

<i>Pedagogu:</i>	Prof.dr. Eqerem YZEIRI
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Programi i studimit:</i>	Master i Shkencave - Gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

Shkurtesë: Kursi do të përqëndrohet në njohjen e koncepteve bazë për gjeografinë politike, raportin e saj me degët e tjera të Gjeografisë si dhe me shkencat e tjera të përfaqësuara, veçanërisht me ato politike. Në thelb, lënda trajton probleme të raportit të gjeografisë politike me gjeopolitikën, me sistemet qeverisëse e të drejtimit, me konceptin e shtetit dhe trajtimi gjeografik i tij në të gjithë komponentët.

Në këtë kurs do të trajtohen edhe problemet që kanë të bëjnë me shkallën hierarkike të ndërtimit administrativ, problematikën sociale e ekonomike të njëjësive hierarkike nën atë të nivelit të shtetit, problemet e mozaikut elektoral, si dhe raportet midis qendrës dhe njëjësive të pushtetit vendor etj.

Objekti i trajtesave të sotme të Gjeografisë politike të Shqipërisë po bëhen, gjithnjë e më shumë, raportet e vendit tonë me problemet Globale: të ekspozicionit demografik, problemet ambientale e të ngrohjes globale, problemet e trafikimit të lëndëve narkotikë, armëve e njerëzve, problemet e konflikteve lokale e çështja e refugjatëve, problemet e piraterisë teknologjike dhe të çdo forme tjetër piraterie etj.

Në këtë lëndë do të trajtohen edhe organizmat dhe organizatat mbi shtetërore dhe raportin e tyre me vendin tonë. Vëmendje e veçantë do të kenë trajtimi i problemeve të asociimit të Shqipërisë në BE.

Problematika rajonale e integriteteve ballkanike. Anëtarësimi i vendit tonë në NATO dhe detyrimet që rrjedhin prej këtij anëtarësimi. Shfrytëzimi i pozitës strategjike të vendit tonë si portë lidhëse në rajon Gjeopolitika europiane dhe Shqipëria. Gjeopolitika e SHBA-së dhe Shqipëria. Integritet ballkanike problematika, përfitimet dhe rrisje ekonomike.

NR	TEMAT E LEKSIONEVE
1	Objekti i Gjeografisë Politike. Momentet kryesore në zhvillimin e Gj. Politike, dukuritë e sotme
2	Gjeografia Politike dhe Gjeopolitika relacionet ndërmjet tyre. Problemet aktuale gjeopolitike ndërkombëtare
3	Roli i Shqipërisë si portë-lidhëse në Ballkan.
4	Roli i faktorëve gjeopolitikë në konsolidimin e kombit dhe të shtetit shqiptar.
5.	BE-ja dhe marrëveshja e stabilizimit asociimit të Shqipërisë.
6	Gjeografia e zgjerimit të NATO-s dhe Shqipëria.
7	Popullsia si elementi themelor i shtetit, pakicat kombëtare dhe problematika e zgjidhjes së drejtë të tyre
8	Gjeografia e ndarjeve administrative, faktorët dhe problematika që e kushtëzojnë atë
9	Gjeografia e preferencave politike

10	Zhvillimi i mozaikut elektoral dhe brezat e kulturës politike në Shqipëri.
11	Orë në dispozicion (mund të ftohet ndonjë lektor për një problem të caktuar)

PLANI I ORËVE PRAKTIKE

NR	TEMA E SEMINAREVE DHE PUNËVE PRAKTIKE
1	Momentet kryesore në zhvillimin e gjeografisë politike nga antikiteti në ditët tona
2	Konceptet gjeopolitike, kontributi i Ratsellit etj, deformimi i gjeopolitikës nga nazistët në periudhën midis dy luftërave botërore. Problemet e sotme gjeopolitike
3	Roli i Shqipërisë si portë-lidhëse në Europën Juglindore.
4	Roli i faktorëve gjeopolitikë në konsolidimin e kombit dhe të shtetit shqiptar.
5	BE-ja dhe marrëveshja e stabilizimit asociativ të Shqipërisë me këtë organizëm.
6	Gjeografia e zgjerimit të NATO-s dhe Shqipëria.
7	Popullsia si elementi themelor i shtetit, pakicat kombëtare dhe problematikat që e kushtëzojnë atë.
8	Gjeografia e ndarjeve administrative, faktorët dhe problematika që e kushtëzojnë atë.
9	Gjeografia e preferencave politike.
10	Mbi mozaikun elektoral
11	Bashkëbisedim përfundimtar

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

Vlerësimi përfundimtar do të bazohet në shumën e pikëve të fituara nga punimi individual, nga pjesëmarrja në diskutime (seminare) dhe nga testi përfundimtar dhe (Esse-ja). Pikët konvertohen në nota.

Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 75 %.

LITERATURA:

1. E. Yzeiri: Gjeografia Politike, Tiranë, 2005
2. E. Yzeiri: Gjeografia Politike e Shqipërisë në Tranzicion, Tiranë, 2002
3. M.I.Glassner: Political Geography, 1998
4. E. Çabej: Shqipëria midis Lindjes dhe Perëndimit, Tiranë 1994
5. D.S.Rugg: Reconstructing the Balkans (a geography of the Neë Southeast Europe), 1996
6. Bill Klinton: Ne luftën Ju paqen, Tiranë, 1999
7. A.Plasari: "Orient apo hije nga Oksidenti), Tiranë, 2001
8. Materiale nga interneti që kanë të bëjnë me zhvillimet e sotme në Ballkan dhe Europë
9. Gjeopolitika, UMB, nr 1,2,3-2008-2009

MIRATOI
Përgjegjësi i Departamentit

Prof.dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016